



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit,
dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III
Gjykatës Kristof Barte
Gjykatës Genël Metro
Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 13 shkurt 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër për Parashtrime mbi Riklasifikimin e Disa Parashtrimeve të Protokolluara

**Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të
Specializuar**
Aleks Uajting

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II (“Trupi Gjykues”) në bazë të neneve 21(2), 40(2) dhe (4) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji) dhe rregullave 82(5), 84(1) dhe 116(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullores), nxjerr këtë urdhër.

I. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

1. Në bazë të neneve 21(2) dhe 40(4) të Ligjit, seancat janë publike, përveçse kur Trupi Gjykues vendos ndryshe në pajtim me Rregulloren.
2. Në bazë të rregullës 82(5) të Rregullores, në qoftë se arsyet për një klasifikim të caktuar pushojnë së ekzistuari, dorëzuesi i parashtrimit të parë i paraqet panelit kërkesë për riklasifikim. Gjithashtu, një panel mund të ndryshojë statusin e një parashtrimi të protokolluar, me kërkesë të një pjesëmarrësi tjetër në proces, apo *proprio motu*.
3. Rregullisht dhe para nxjerrjes së aktgjykimit, trupi gjykues rishikon klasifikimin e dokumentacionit të procesit gjyqësor dhe të provave, dhe, kur është e zbatueshme, urdhëron riklasifikimin e statusit të dokumentacionit përkatës.

II. DISKUTIM

4. Në përputhje me rregullën 84(1), Trupi Gjykues e gjykon të nevojshme të rishikojë klasifikimin e disa parashtrimeve të protokolluara në dosjen e çështjes, në mënyrë që të respektohet parimi i procesit publik, i cili vlen jo vetëm për seancat në sallën e gjyqit, por edhe për parashtrimet e protokolluara dhe çdo material tjetër në dosjen e çështjes.¹

¹ KSC-BC-2020-07, F00501, Trupi Gjykues II, *Urdhër mbi Riklasifikime dhe Versione të Redaktuara Publike* (“Urdhri i Trupit Gjykues”), 16 dhjetor 2021, para. 4.

5. Duke ndërmarrë këtë veprim, vëmendje i duhet kushtuar si parimit të publicitetit, siç përcaktohet në nenet 21(2) dhe 40(4), ashtu edhe detyrës së Trupit Gjykes për të siguruar mbrojtjen e dëshmitarëve dhe informacionit konfidencial.² Rrjedhimisht Trupi Gjykes ka përgjegjësinë të sigurojë që parashtrimet e protokolluara në dosjen e çështjes të kenë klasifikimin e duhur dhe, në përputhje me këtë, të riklasifikojë çdo parashtrim të protokolluar *proprio motu* ose në bazë të një kërkesë, nëse nuk ekzistojnë më arsyet për klasifikimin aktual.³

6. Në pajtim me nenin 23, rregullën 80 dhe nenin 33 të Udhëzuesit të Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara, nga versionet e redaktuara publike të parashtrimeve të protokolluara duhet të hiqet çdo informacion që zbulon: (i) emrin, identitetin ose të dhënat e tjera personale të punonjësve të ZPS-së (që nuk janë dëshmitarë në këtë çështje gjyqësore); (ii) organizata ose subjekte që bashkëpunojnë me ZPS-në mbi bazë konfidenciale; (iii) dokumente ose pjesë të tyre që u janë dhënë palëve dhe pjesëmarrësve në mënyrë konfidenciale; dhe (iv) përmbajtjen e çdo dokumenti tjetër konfidencial sipas urdhrave të Dhomave të Specializuara.⁴

7. Bazuar në sa më sipër, Trupi Gjykes i kërkon ZPS-së që të dorëzojë një version të redaktuar konfidencial të parashtrimit të mëposhtëm në KSC-BC-2020-06, aktualisht i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*: F00350, 14/06/2021.

8. Trupi Gjykes i kërkon ZPS-së të dorëzojë versione të redaktuara publike të parashtrimeve të mëposhtme në KSC-BC-2020-06, aktualisht të klasifikuara si konfidenciale. Nëse ZPS-ja gjykon që një parashtrim mund të riklasifikohet si publik

² Urdhri i Trupit Gjykes, para. 5.

³ Urdhri i Trupit Gjykes, para. 6.

⁴ *Shih p.sh.* KSC-BC-2020-07, F00328, Trupi Gjykes II, *Urdhër mbi Mocionet e Mbrojtjes sipas Rregullës 117*, 27 shtator 2021, para. 16.

pa pasur nevojë për redaktime të mëtejshme në përputhje me rregullën 82(5), ZPS-ja mund ta bëjë të ditur këtë:

- F00555CONF/RED, 02/11/2021
- F00665, 31/01/2022
- F00670CONF/RED, 31/01/2022
- F00678CONF/RED, 03/02/2022
- F00703, 18/02/2022
- F00704, 18/02/2022
- F00708, 24/02/2022
- F00709/A01/SCONF, 24/02/2022⁵
- F00740CONF/RED, 21/03/2022
- F00767, 13/04/2022
- F00774CONF/RED, 20/04/2022
- F00788, 29/04/2022
- F00875CONF/RED, 18/07/2022
- F00896, 25/07/2022
- F00910, 03/08/2022
- F00917, 08/08/2022
- F01004CONF/RED, 06/10/2022
- F01022, 10/10/2022
- F01090CONF/RED, 07/11/2022
- F01105CONF/RED, 16/11/2022
- F01127, 29/11/2022

⁵ Kërkesa në fjalë është e veçantë dhe i shtohet urdhrin të mëhershëm që i kërkon ZPS-së të parashtrijë deri të mërkurën, 15 shkurt 2023 një version më pak të redaktuar të Dosjes Paraprake të ZPS-së. *Shih F01229/CONF/RED, Version i Redaktuar Konfidencial i Vendimit mbi Redaktimet e Aktakuzës, 27 janar 2023, para. 40(b).*

9. Në rast se ZPS-ja dëshiron të ruajë klasifikimin aktual për disa apo për të gjitha parashtrimet e protokolluara që përmenden në paragrafët 7 dhe 8, duhet të specifikojë arsyet për ruajtjen e klasifikimit aktual në përputhje me rregullën 82(3), si dhe të tregojë nëse dhe kur mund të ndryshohet statusi i parashtrimit përkatës.

10. Gjithashtu Trupi Gjykues i kërkon Mbrojtjes së Thaçit të dorëzojë versione të redaktuara publike të parashtrimeve të mëposhtme në KSC-BC-2020-06, aktualisht të klasifikuara si konfidenciale. Nëse Mbrojtja e Thaçit gjykon që një parashtrim mund të riklasifikohet si publik pa pasur nevojë për redaktime të mëtejshme në përputhje me rregullën 82(5), Mbrojtja e Thaçit mund ta bëjë të ditur këtë:

- F00109, 30/11/2020
- F00194, 10/02/2021
- F00284, 07/05/2021
- F00325, 27/05/2021
- F00589, 01/12/2021
- F00688, 11/02/2022
- F00696, 15/02/2022
- F00702, 17/02/2022
- F00725, 07/03/2022
- F00791, 02/05/2022
- F00792, 02/05/2022
- F00812, 23/05/2022
- F00900, 28/07/2022
- F01020, 07/10/2022
- F01060, 27/10/2022
- F01115, 18/11/2022
- F01129, 29/11/2022

- F01136, 02/12/2022
- F01145, 08/12/2022
- F01193, 10/01/2023
- F01198, 12/01/2023

11. 9. Në rast se Mbrojtja e Thaçit dëshiron të ruajë klasifikimin aktual për disa apo për të gjitha parashtrimet e protokolluara që përmenden në paragrafin 10, duhet të specifikojë arsyet për ruajtjen e klasifikimit aktual në përputhje me rregullën 82(3), si dhe të tregojë nëse dhe kur mund të ndryshohet statusi i parashtrimit përkatës.

12. Trupi Gjykesues i kërkon Mbrojtjes së Veselit të dorëzojë versione të redaktuara publike të parashtrimeve të mëposhtme në KSC-BC-2020-06, aktualisht të klasifikuara si konfidenciale *ex parte*. Nëse Mbrojtja e Veselit gjykon që një parashtrim mund të riklasifikohet si publik pa pasur nevojë për redaktime të mëtejshme në përputhje me rregullën 82(5), Mbrojtja e Veselit mund ta bëjë të ditur këtë:

- F00170, 11/01/2021
- F00566, 12/11/2022
- F00662, 28/01/2022
- F00681, 08/02/2022
- F00686, 10/02/2022
- F00689, 11/02/2022
- F00700, 16/02/2022
- F00721, 25/02/2022
- F00726, 07/03/2022
- F00757, 31/03/2022
- F00783, 25/04/2022
- F00901, 29/07/2022
- F01052/COR, 25/10/2022

- F01063, 27/10/2022
- F01194, 10/01/2023
- F01197, 11/01/2023

13. Në rast se Mbrojtja e Veselit dëshiron të ruajë klasifikimin aktual për disa apo për të gjitha parashtrimet e protokolluara që përmenden në paragrafin 12, duhet të specifikojë arsyet për ruajtjen e klasifikimit aktual në përputhje me rregullën 82(3), si dhe të tregojë nëse dhe kur mund të ndryshohet statusi i parashtrimit përkatës.

14. Trupi Gjykes i kërkon Mbrojtjes së Selimit të dorëzojë versione të redaktuara publike të parashtrimeve të mëposhtme në KSC-BC-2020-06, aktualisht të klasifikuara si konfidenciale. Nëse Mbrojtja e Selimit gjykon që një parashtrim mund të riklasifikohet si publik pa pasur nevojë për redaktime të mëtejshme në përputhje me rregullën 82(5), Mbrojtja e Selimit mund ta bëjë të ditur këtë:

- F00105, 27/11/2020
- F00565, 12/11/2021
- F00899, 28/07/2022
- F01049, 21/10/2022
- F01062COR, 28/10/2022 (me përjashtim të shtojcës).

15. Në rast se Mbrojtja e Selimit dëshiron të ruajë klasifikimin aktual për disa apo për të gjitha parashtrimet e protokolluara që përmenden në paragrafin 14, duhet të specifikojë arsyet për ruajtjen e klasifikimit aktual në përputhje me rregullën 82(3), si dhe të tregojë nëse dhe kur mund të ndryshohet statusi i parashtrimit përkatës.

16. Trupi Gjykes i kërkon Mbrojtjes së Krasniqit të dorëzojë versione të redaktuara publike të parashtrimeve të mëposhtme në KSC-BC-2020-06, aktualisht të klasifikuara si konfidenciale. Nëse Mbrojtja e Krasniqit gjykon që një parashtrim

mund të riklasifikohet si publik pa pasur nevojë për redaktime të mëtejshme në përputhje me rregullën 82(5), Mbrojtja e Krasniqit mund ta bëjë të ditur këtë:

- F00564, 12/11/2021
- F00587, 01/12/2021
- F01051, 21/10/2022
- F01061, 27/10/2022

17. Në rast se Mbrojtja e Krasniqit dëshiron të ruajë klasifikimin aktual për disa apo për të gjitha parashtrimet e protokolluara që përmenden në paragrafin 16, duhet të specifikojë arsyet për ruajtjen e klasifikimit aktual në përputhje me rregullën 82(3), si dhe të tregojë nëse dhe kur mund të ndryshohet statusi i parashtrimit përkatës.

III. VENDIM

18. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- KËRKON** që për çdo parashtrim të protokolluar të përmendur në paragrafët 7 dhe 8, ZPS-ja të paraqesë brenda **3 prillit 2023**: (a) arsyet që ka për ruajtjen e klasifikimit ekzistues të parashtrimit të protokolluar; (b) versionin publik të redaktuar përkatës; ose (c) një pohim që parashtrimi i protokolluar mund të riklasifikohet si publik në gjendjen aktuale.
- KËRKON** që për çdo parashtrim të protokolluar të përmendur në paragrafin 10, Mbrojtja e Thaçit të paraqesë brenda **8 majit 2023**: (a) arsyet që ka për ruajtjen e klasifikimit ekzistues të parashtrimit të protokolluar; (b) versionin publik të redaktuar përkatës; ose (c) një pohim që parashtrimi i protokolluar mund të riklasifikohet si publik në gjendjen aktuale.
- KËRKON** që për çdo parashtrim të protokolluar të përmendur në paragrafin 12, Mbrojtja e Veselit të paraqesë brenda **8 majit 2023**: (a) arsyet që ka për ruajtjen e klasifikimit ekzistues të parashtrimit të protokolluar; (b) versionin

publik të redaktuar përkatës; ose (c) një pohim që parashtrimi i protokolluar mund të riklasifikohet si publik në gjendjen aktuale.

- d. **KËRKON** që për parashtrimin e protokolluar të përmendur në paragrafin 14, Mbrojtja e Selimit të paraqesë brenda **8 majit 2023**: (a) arsyet që ka për ruajtjen e klasifikimit ekzistues të parashtrimit të protokolluar; (b) versionin publik të redaktuar përkatës; ose (c) një pohim që parashtrimi i protokolluar mund të riklasifikohet si publik në gjendjen aktuale.
- e. **KËRKON** që për parashtrimin e protokolluar të përmendur në paragrafin 16, Mbrojtja e Krasniqit të paraqesë brenda **8 majit 2023**: (a) arsyet që ka për ruajtjen e klasifikimit ekzistues të parashtrimit të protokolluar; (b) versionin publik të redaktuar përkatës; ose (c) një pohim që parashtrimi i protokolluar mund të riklasifikohet si publik në gjendjen aktuale.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith III

Kryegjykatës

E hënë, 13 shkurt 2023

Në Hagë, Holandë.